



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

**i mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 17.11.2023, duke filluar në orën 8:30.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Pëllumb Bajçinovci, kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri, Shegë Beqiri, Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Bahri Gashi dhe Mirsad Vitia.

**Në mbledhje ishin të pranishëm edhe:** Osman Bllaca, Valbona Ahmeti – Makolli - drejtore e Drejtorisë së Financave, Ilirik Musliu – drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve publike, Seniha Bajraktari – zyrtare e Drejtorisë së Shërbimeve publike, Dukagjin Gashi-zyrtar i Drejtorisë së Shërbimeve publike, Doruntinë Maloku-drejtore e Drejtorisë së Pronës, Florian Dushi - drejtor i Drejtorisë së Inspektionit, Arbër Sadiki-drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Diellon Gjonbalaj – zyrtar i Zyrës ligjore.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Pëllumb Bajçinovci - kryesues i komitetit, me këtë:

### REN D I T E

1. **Projektregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës;**
2. **Projektregullorja për menaxhimin e mbeturinave dhe Plani komunal i menaxhimit të mbeturinave 2023-2027;**
3. **Propozim-rregullorja për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës për më pak se një vit;**
4. **Propozim-rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës 01-434/01-0094474/17, dt.24.4.2017;**
5. **Propozim-vendimi për caktimin e shkallës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024;**
6. **Shfuqizimi i Vendimit për vulën në transaksion;**
7. **Propozim-vendimi lidhur me Planin e integritetit në Kryeqytetin Prishtinë 2023-2026;**

## 8. Propozim – vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për cilësinë e ajrit në Komunën e Prishtinës 2023-2027.

### Pika e parë

#### Projektregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës

Lidhur me këtë pikë **Projektregulloren për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës, Florian Dushi**, - drejtor na informoi se është paraqitur si kërkesë në bazë të ankesave, kërkesave dhe vërejtjeve të shumta të qytetarëve për ndryshimin e kësaj rregulloreje se si projekt nuk ishte përfshirë në implementimin në të gjithë kryeqytetin, kështu që me takime me qytetarë dhe me zyrtarë të “Prishtina Parkingut” që të definohen disa çështje, të cilat konsiderohen se janë të rëndësishme të ndryshohen, plotësohen në rregullore. Aspektet më të rëndësishme që rregullohen, ndërliken me definimin e hapësirave në mënyrë të qartë dhe sinalizimin e tyre duke u ndërlidh edhe me kufizimet e zonave të ndryshme në kryeqytet sepse duke mos qenë të definuara sa duhet këto zona, është bërë keqpërdorimi duke i ikur pagesës. Gjithashtu është rregulluar edhe operimi i parkingjeve private në kushtet dhe kriteret që duhen ato t’i plotësojnë, taksat që duhet të paguajnë, kushtet teknike se si duhet të funksionojnë, mënyrën e operimit apo pajisjes me leje. Sa i përket parkingjeve publike i nënshtrohen edhe aspekteve që ndërliken me mobilitetin për shkak të ndryshimit që mund të kërkohen nga implementimi i projekteve të ndryshme në kryeqytet. Me këtë rregullore po ashtu kemi definuar edhe parkingjet e hapura rezidenciale dhe është vendosur kufizimi në orët e pasditës për vizitorët. Rregullorja gjithashtu përcakton kushtet teknike që duhet të zbatohen në raport me operimin e “Prishtina Parkingut” po ashtu edhe operatorët tjerë privat me qëllim që të mos shkelen të drejtat e qytetarëve në raport me parkingjet. Janë përcaktuar kushtet dhe detyrat e “Prishtina Parkingut”, të cilat sigurojnë mbikëqyrje të vazhdueshme për vendparkingjet, sidomos për PAK-ra. Është zgjeruar lista e kushteve të përgjithshme të parkingjeve duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e të gjitha palëve. Është qartësuar se tani që banorët për veturën e parë janë të liruar nga pagesa mujore, që më parë s’ka qenë deri më tani, kurse ata do të bëjnë vetëm njëherë një pagesë në momentin e regjistrimit të makinës së tyre e që është një tarifë prej 10 euro. Po ashtu është rregulluar edhe aspekti dhe përgjegjësia e Drejtorisë dhe Inspektionit, tash është i qartë në këto raporte. Njëherazi Rregullorja ka një çmimore të standardizuar e cila është bashkëngjitur dhe eliminon dallimet apo subjektivitetin grafik të ndërmarrjes ose çdo subjekti të tretë të kësaj ndërmarrjeje.

**Gëzim Sveçla:-** pyeti se sa janë marrë parasysh rekomandimet që kanë dal nga dëgjimet publike nga drafti i parë në këtë draftin që na është dorëzuar neve dhe a mendoni që ky draft është në përputhshmëri me ligjet, të cilat i referoheni në bazën ligjore të rregullores dhe rrjedhimisht me Kushtetutën.

**Florian Dushi** u përgjigj pyetjeve të parashtruara nga parafolësi.

**Bahri Gashi:** - parashtrroi pyetjet: pse t’i lihet shëfit të parkingut të ndërmarrjes me vendos për çmime. Po ashtu pyeti pse nuk është e kufizuar sa është vlera e merimangës kur e bartë veturën, ish pa çmim aty dhe - tre vende vendos kryeshefi i ndërmarrjes për çmime. Tutje tha se një familje që i ka 4 vetura, duhet të paguajë 1.750 € dhe kësaj tatimi në pronë është më i vogël dhe kështu parkingu ka dalë ngarkesë më e madhe për ekonominë familjare. Po ashtu ai shprehu shqetësimin për banorët rezidentë, duke pyetur në vazhdim se a keni marrë ndonjë mostër nga Tirana, Sofja etj, a i keni parë rregulloret e rajonit për parkingje për banorë rezidentë.

**Florian Dushi:** - u përgjigj pyetjeve të parashtruara nga parafolësi.

**Osman Bllaca:** - tha, sa i përket pyetjes për merimanga është në rregull, është pika e 12 e cila e cakton çmimin e merimangës.

**Leutrim Retkoceri:** - tha është rregullorja më e gjatë që është punuar afër 2 vite, është lajm i mirë që banorëve rezidentë lirohen një familje lirohet nga parkingjet sepse hapësirat përrteh është dashur me ju takuar atyre. Po ashtu tha se koha për të cilën është llogaritë 5 minutësh prej momentit që e parkon deri në dalje është kohë e shkurtë, kështu që është dashur 10 minuta me qenë minimumi.

-Te neni 20 te kategoritë e liruara nga obligimet e pagesës për parkim janë 4 kategori të liruara: veturat e Kuvendit komunal, veturat diplomatike, personat me aftësi të kufizuara dhe automjetet e shërbimeve emergjente. Mendoj te shërbimet emergjente përveç policisë, zjarrfikësve duhet të shtohet edhe Forca e Sigurisë së Kosovës. Kategori tjetër që duhet të futet në rregullore për t'u liruuar janë edhe invalidët e Luftës të UÇK-së, të pajisën me një kartelë që i liron nga pagesa e parkingjeve. Çështje tjetër është edhe çështja e formës së dërgimit të rregulloreve e seancës së jashtëzakonshme kam fjalën për të gjitha rregulloret për shkak të transparencës, të gjitha rregulloret duhet të vinë në seancë për t'i votuar për të shkuar mandej në dëgjim publik e pastaj të kthehen prapë në Kuvend. Kjo do për t'i dhënë më shumë transparencë qytetarëve, qytetit edhe neve për t'i dhënë rekomandimet. Kam frikën se seanca e jashtëzakonshme do t'i kalojë rregulloret me ndonjë lëshim, do të kthehen në Kuvend dhe do të duhet të bëhet dy herë një punë që do të mund të bëhej njëherë e mirë.

**Osman Billaca:**- dha sqarime lidhur me çështjen e rregulloreve lidhur me diskutimet publike.

**Leutrim Retkoceri:**- tha, me faktin që nuk është votuar për të shkuar në diskutim publik, unë mendoj që nuk ke bërë mirë, e ke ndryshuar një zakon të Kuvendit komunal e cila është e cekur edhe në Statutin e Prishtinës që obligohet që forma e inicimit dhe dërgimit të Rregulloreve që të shkojë përmes Kuvendit komunal.

**Osman Billaca:**- tha se të gjitha rregulloret i kemi dërguar për konsulta paraprake e kemi marrë vendimin dhe miratimin njëherë prej Kuvendit dhe e ka ndryshuar dhe kemi bërë platforma për konsultime publike, është dokumente që i nënshtrohet 30 ditë diskutimit publik të hapur dhe vazhdojnë procedurat tutje.

**Leutrim Retkoceri:**- tha, ne diskutime mund të bëjmë pa fund, por përderisa e kemi një dokument i cili na obligon, ne më parë duhet me ndërruar dokumentin kryesor të komunës Statutin e pastaj t'i përmbahemi asaj, derisa ne e kemi një Statut i cili e sqaron saktë se si vazhdon rrjedha e dokumentit të rregullores ne jemi duke e shkel Statutin. Udhëzimet administrative mund të ndryshohen, por duhet të ndryshojë Statuti sepse është organi më i lartë që e kemi votuar në seancë, dhe çka e dëmton procesin demokratik, ligjor konsultimi ose rekrutimi i rregulloreve për të shkuar në diskutim publik, nuk e dëmton asgjë vetëm e forcon.

**Bahri Gashi:**- tha kjo rregullore të shikohet, të analizohet se a është mirë apo nuk është mirë.

**Osman Billaca:**- tha si dokumente na i sjellim të gjitha standardet që janë të përcaktuara për secilin dokument pa ardhur në Kuvend që thotë Udhëzimi administrativ dhe Rregullorja për transparencë që është në nivel të komunës, Zyra ligjore prapë do t'i shikojë konsultimet paraprake dhe vazhdojnë më tutje si ka qenë praktikë e mëhershme.

**Gëzim Sveçla:**- tha na i dërgoni materialet me kohë në rregull dhe këto materiale a i dërgoni në MAPL, a i keni dërguar si na i keni dërguar neve apo i dërgoni këto shtesë.

**Kryesuesi:**- tha pasi t'i votoni i dërgojmë në MAPL.

**Gëzim Sveçla:**- tha ne punojmë në bazë të rregullores, ligjeve duhemi me u bazuar gjithë në procedurë e jo të vjen rregullorja me 30 faqe e ndryshuar 30 minuta para seancës.

**Kryesuesi:**- tha nuk është e ndryshme ndoshta një detaj i vogël.

**Bahri Gashi:**- tha për 72 orë na i keni dërguar 100 faqe material, ku ta gjej unë ndryshimin dhe kjo është praktikë shumë e keqe.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Projektrregullorja për organizimin dhe shfrytëzimin e parkingjeve të Komunës së Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

## Pika e dytë

### Projektregullorja për menaxhimin e mbeturinave dhe Plani komunal i menaxhimit të mbeturinave 2023-2027

**Ilirik Musliu**, drejtor: - na informoi për përmbajtjen e kësaj rregulloreje se si DSHP një prej sfidave kryesore, të cilat i kanë është menaxhimi i mbeturinave, duke shtuar se kemi filluar me një master-plan për menaxhimin e mbeturinave dhe në të njëjtën kohë jemi duke punuar në bashkëpunim edhe me GIZ-in dhe Care W, projektet që mendoj do t'i bëjmë zgjidhje këtij problemi, kështu që gjatë punimit të këtij master-plani e kemi pa se rregullorja e vitit 2016 duhet gjithsesi të ripërtërihet dhe të jetë më e plotë në aspektin e trajtimit të disa llojeve të mbeturinave dhe kategorizimit të tyre. Si rregullore e trajton llojin e mbeturinave, tregon cilat mbeturina përjashtohen, siç është rasti i mbeturinave të rrezikshme, përgjegjësitë e komunës, kategorizimi i këtyre degjeneruesve të mbeturinave, të drejtat që ata i kanë dhe detyrimet.

Tjetër çka është me rëndësi është edhe trajtimi i mbeturinave vëllimore dhe ndërtimore, mbeturinat që kemi më së shumti problem dhe për këtë lloj të mbeturinave nuk kemi qendër për trajtimin dhe grumbullimin e tyre, por me këtë projektin Care W e kemi paraparë edhe një qendër të tillë. E mirë e kësaj rregulloreje është edhe lirimi prej taksës sidomos të diasporës, ata të cilët nuk banojnë 12 muaj, por 2 muaj, për ta kemi bërë të mundur vetëm sa e shfrytëzojnë pronën e tyre, atë ta paguajnë. Po ashtu kemi edhe një ndryshim të çmimit të amvisërisë diku prej 4.70 çmimi i vjetër që ka qenë, në 6.20 me TVSH dhe një rritje të çmimit të deponisë dhe ky ndryshim ka me vazhduar ku çdo vit ka mu rrit për 1 €, kurse tash për momentin veç është rrit 1 € për ton. Këto ndryshime që janë bërë ne si DSHP, rregulloren e kemi dërguar me kohë, e kemi kryer dëgjimin publik dhe brenda ndërmarrjes "Pastrimi" edhe brenda drejtorive tjera e kemi dërguar me kohë, ndërsa vërejtjet kanë qenë me vonesë, ndërsa pjesa më e madhe e ndryshimeve janë ligjore nuk e prekin përmbajtjen dhe ndryshimet i kemi përfshirë.

**Gëzim Sveçla:** - tha ju keni nisur me çmime të reja në bazë të analizës të kompanisë, a mund të di sa është ngritur çmimi në deponi, sa është përqindja.

**Dukagjin Gashi:** - tha për 2 € për ton është ngritja në deponi, në përqindje 30 % plus çdo vit rritet për 1€.

**Gëzim Sveçla:** - pyeti, analiza e bërë prej kompanisë në fjalë a e parashih rritjen prej 3.1% për amëvisëri, dhe a mund ta shohim në atë analizë, atë material. Po ashtu tha se janë rrit çmimet vetëm për dy kategori.

**Dukagjin Gashi:** - u përgjigj, komplet 31 % u rrit, çdo gjë është bërë në bazë të analizës dhe mund t'ua sjell materialin, kurse rritjet janë bërë për çdo lloj kategorie, janë disa kategori të veçanta që përpara nuk ka pas shërbim.

**Gëzim Sveçla:** - pyeti për 7 m<sup>2</sup> sa e ka pasur çmimin me rregulloren e vjetër, po ashtu tha si total çka mendoni me arrit me këtë ngritje dhe a ka prodhuar ngritje të çmimeve.

**Dukagjin Gashi:** - dha sqarime për pyetjet e parashtruara.

**Mirsad Vitija:** - pyeti se a kanë bërë analizë vetëm për me ngrit çmimin e jo edhe si me pastruar qytetin.

**Ilirik Musliu:** - tha se kanë bërë një master-plan, kemi bërë një plan "Pastrimi" dhe Care W, ndërsa shtojca që është çmimorja me aneks është e ndarë vetëm çmimet dhe kostot. Për ta ndryshuar gjendjen në kryeqytet në aspektin e shërbimit ne po mendojmë prej marsit 2024 të fillojmë hapat e parë me projektin Care W.

**Gëzim Sveçla:** - pyeti se a është problemi vetëm te paratë.

**Ilirik Musliu:** - tha jo nuk është problemi vetëm te paratë, por një prej arsyeve janë edhe paratë, si çmim mendoj është i arsyeshëm në bazë të analizave të kostove.

**Gëzim Sveçla:** - tha me paguar 6 € qytetarët është në rregull nëse një qytet është në rregull me pastërti, nëse ka qenë çështja që me u rrit 1,50 te konsumatori e me u zgjidh ky problem, mendoj është dashur më herët të kërkoni para prej Kuvendit sepse çdo vit po na teprojnë para, e kishim zgjidh këtë problem shumë të rëndësishëm për qytetarin.

**Leutrim Retkoceri:** - tha se si grup jemi ulur dhe kemi punuar i kemi dërguar disa rekomandime për me ndryshuar rregulloren që e kemi përpara drejtor, duhet të shikohet edhe ana drejtshkrimore dhe disa teknike dhe është mirë që rregullorja të vijë në Kuvend dhe Kuvendi të ushtrojë kompetencën e vet lidhur me rregulloren e që secili të jep mendimin e vet, duke sugjeruar tutje që rregullorja nuk mund të përmbajtje një anë paragrafët me numra e anën tjetër me qenë me shkronja dhe me numra romak. Pastaj tha se Ligji për procedura nuk e parashihet kështu, andaj këto çështje të rregullohen dhe po ashtu janë edhe disa çështje në lidhje me riformulimin e neneve që duhet rregullorja të jetë sa më e qartë për qytetarin.

**Ilirik Musliu:** - tha si DSHP e kemi pasur obligim t'i trajtojmë problematikat të punojmë në përmbajtje dhe nesër me rezultu me sukses në terren, kurse sa i përket lektorimit është zyra e veçantë ne e dërgojmë dhe po ashtu e dërgojmë edhe te Zyra ligjore.

**Kryesuesi:** - tha sa i përket gabimeve drejtshkrimore i rregullojmë shumë shpejt, siç u tha pasi nuk ka ndryshime teknike, do t'i diskutojmë dhe besoj do të merren parasysh sugjerimet e juaja.

**Bahri Gashi:** - pyeti se çka është kjo certifikatë e menaxhimit të mbeturinave në Sektorin e menaxhimit të mbeturinave m'i dërguar bizneset me aplikuar, çka keni menduar ju për këtë çështje, çka mendoni të bëni, po ashtu pyeti sa e ka koston kjo certifikatë dhe a është online.

**Dukagjin Gashi:** - tha po mendojmë me krijuar një rregull që duhet me u certifikuar çdo biznes që është duke i respektuar rregullat e menaxhimit të mbeturinave në qytetin tonë, kështu që secili biznes të ketë kontejnerin e vet, kurse sa i përket pyetjes për kosto të certifikatës nuk ka kosto hiç, nuk është online, por mund ta bëjmë.

**Bahri Gashi:** - u interesua si bëhet konfiskimi i pëlqimit sanitar nga Komuna e Prishtinës, kur ju nuk e jepni dokumentin si mund ta konfiskoni.

**Dukagjin Gashi:** - u përgjigj në pyetjet e parashtruar.

**Bahri Gashi:** - u interesua për secilin biznes, a kanë kontejner specifik, të veçantë p.sh. për hamburger, fast food 1 me 1 ku do ta vendos kontejnerin.

**Dukagjin Gashi:** - tha për këtë arsye nuk kemi përcaktuar masa, në theks 1 me 1.

**Bahri Gashi:** - tha në një pikë thuhet për mbeturinat ndërtimore ju e përcaktoni kompaninë prej të cilës kompania ndërtuese do ta blejë kontejnerin, a ka treg të lirë në Kosovë, qysh ju me ia imponuar me shkuar me ble te ky, ti i cakton standardet e jo kompaninë.

**Dukagjin Gashi:** tha për të menaxhuar mbeturinat, kemi menduar mos me i lejuar më me traktor (person privat) me u shëtit dhe me bërë deponi ilegale.

**Ilirik Musliu:** - dha sqarime shtesë.

**Bahri Gashi:** - tha ti ke thënë një kompani te neni 10, e ke kompania që e cakton komuna.

**Ilirik Musliu:** - tha thirrjes në kompaninë e përcaktuar.

**Bahri Gashi:** - tha e kompanisë së përcaktuar nuk ka kritere, nuk ka standarte, ti nuk mundesh me thënë kjo kompani, ti me ia caktuar ku me shkuar me ble kontejnera.

**Ilirik Musliu:** - dha sqarime.

**Bahri Gashi:** - pyeti si e japin këtë lejen e mjedisit njësisë së mjedisit që e ka dhënë më herët, leja mjedisore e zëvendëson licencën që më parë është plotësuar në Ministrinë e Mjedisit, si e jepni ju këtë leje si e zëvendësoni, a është kualitet, a është ngarkesë për biznesin, a e keni pyet ministrinë se ju del problem me ministrinë.

**Dukagjin Gashi:** - tha ka ndryshuar Ligji i Mbeturinave dhe si rezultat ka reflektuar edhe në rregullore. Tash e tutje nuk lëshohet më licencë në ministri, por leje mjedisore komunale në Drejtorinë e Urbanizmit në bazë të Ligjit të Mbeturinave.

**Nora Kelmendi:** - tha leje mjedisore komunale ju po lëshoni, ministria ka lëshuar, tash ju këtu e keni që ju lëshoni, a është kjo në kundërshtim me ligjin.

**Dukagjin Gashi:** - tha ligji i ri thotë se komuna e lëshon, Drejtoria e Urbanizmit.

**Nora Kelmendi:-** tha prej fjalës licencë është ndryshuar në leje, ndryshimi i ri që është bërë në vitin e kaluar, e nuk thotë që komuna e lëshon.

**Dukagjin Gashi:-** për këtë çështje kemi interpretim prej Ministrisë së Mjedisit ku dhe na udhëzon që ne me lëshuar leje mjedisore komunale për menaxhimin e mbeturinave.

**Gëzim Sveçla:-** pyeti cili ligj për menaxhimin, cili nen.

**Seniha Bajraktari:-** tha Ministria e Planifikimit lëshon leje mjedisore, ndërsa komunat janë të obliguara për aktivitetet të cilat nuk kanë kapacitet të madh të ndotjes, lëshohen lejet mjedisore komunale në këtë rast këto kompani kanë qenë të licencuara, tash janë të obliguara të krijojnë një raport të vlerësimit të ndikimit mjedisor të dërgojnë ne Sektorin e mjedisit në Drejtorinë e Urbanizimit, ata e shqyrtojnë dokumentet përkatëse për me pa se a i plotësojnë kriteret apo jo si kompani për menaxhimin e mbeturinave dhe i pajisin me leje mjedisore komunale e jo leje mjedisore, sepse këtu ka një dallim.

**Bahri Gashi -** tha mendoj se shtrenjtimi i mbeturinave është gabim dhe mendoj që kompania “Pastrimi” edhe ju që jeni akterë të përfshirë në këtë. Në vitin 2024 me këtë target duke i përmirësuar shërbimet dhe kur t’i përmirësoni shërbimet me plotë të drejtë dilni para qytetarëve dhe i njoftoni për shtrenjtimin e mbeturinave. Përmirësoni shërbimet, përmirësoni kapacitetin, rritni kapacitetin e punës sepse rriten edhe shpenzimet, këtu vetëm se ngarkohet qytetari. Me këtë rregullore po e ngarkoni biznesin me lloj-lloj certifikate, ka qenë një ide që me u liruar biznesi prej disa taksave dhe obligimeve tani ju me këto rregullore po i sjellni biznesit certifikatë, leje kontejner etj.

**Ilirik Musliu:-** tha po është e vërtetë, po mandej edhe komenti ishte shumë me vend për të punuar në digjitalizim dhe për të kursyer kohën.

**Bahri Gashi -** tha online asgjë mos bëni, vetëm çmimin mos e shtrenjtoni.

**Leutrim Retkoceri -** tha se mendon se në këtë paragraf të bëhet një ndryshim i vogël, duke plotësuar paragrafin, këtu nëse referohet ofrimi i shërbimeve jashtë orarit të paraparë për grumbullimin e mbeturinave, që nënkupton se kompania duhet ta ketë një orar për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme, d.m.th. e ka një orar, por jashtë këtij orari nëse kompania punon pas orës 16:00 ose jashtë orarit. Po ashtu ai tha se është me rëndësi të realizohet përmes thirrjes në kompanitë e licencuara apo te pajisura me leje ku duhet të shtohet nga Komuna e Prishtinës, vetëm se mos të specifikohet, mos të jetë vetëm 1 kompani, por me qenë kompanitë në shumës, ndoshta do të keni nevojë për me i pas tri apo katër kompani ose me tepër, caktojani “Pastrimit”.

**Bahri Gashi:-** tha lëreni “Pastrimin” të bëjë një çmimore, se nuk është ekonomi e tregut, por është treg i lirë, por megjithatë “Pastrimit” me i ndihmuar me e shty përpara, që me u ngrit në këmbë e pastaj me ia ndërruar disa gjëra.

**Nora Kelmendi -** tha a i merrni parasysh ju rekomandimet e asamblistëve që i japin në seancë për nenet e caktuara, p.sh., herën e kaluar drejtori i shëndetësisë i ka marrë parasysh dhe e ka ndryshuar rregulloren në bazë të rekomandimeve.

**Ilirik Musliu:-** tha ne kemi biseduar dhe i kemi trajtuar të gjitha në rregull, mund edhe të gabojmë, por ndryshimi duhet të bëhet në momentin që ju i keni komentet, nuk është patjetër më 1 janar me hy në fuqi kjo rregullore. Po ashtu tha se prapë po pajtohem me Leutrimin që duhet kaluar në atë pjesën që me e pas edhe ju afatin dëgjimor prej 30 ditë, me pas mundësi të punoni me grupe dhe kështu na lehtësohet edhe neve puna.

**Kryesuesi -** tha edhe diskutimet edhe referencat, që i keni dhënë i kemi shënuar dhe do t’i përcjellim.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Projektregullorja për menaxhimin e mbeturinave dhe Plani komunal i menaxhimit të mbeturinave 2023-2027 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e tretë**

Faqe 6 nga 11

## **Propozim – rregullorja për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se një vit**

**Nora Kelmendi:-** kërkoi sqarim nga drejtoresha Doruntrinë të tyre gojë se çfarë ndryshime janë bërë që na keni sjell tani 5 minuta para mbledhjes së Kuvendit.

**Doruntinë Maloku:-** dha sqarime se të gjithë ndryshimet janë bërë te neni 10 ose shqyrtimi i kërkesave ne draftin e vjetër është paraparë se Kryetari i kryeqytetit për të themeluar një komision nga 7 anëtarë, prej të gjitha drejtorive gati për shqyrtimin e kërkesave që vijnë në kthim, mirëpo për shkak të aplikimeve të shumta edhe në Drejtorinë e Pronës edhe në Drejtorinë e Shërbimeve Publike që janë dy drejtoritë kyçe. Tani në draftin e ri janë dy komisione të cilat e shqyrtojnë, aplikimet të cilat vijnë, ato që kanë qenë në Drejtorinë e Shërbimeve Publike vazhdojnë atje dhe këto tjerat mbesin në Drejtorinë e Pronës siç kanë qenë, d.m.th ky është ndryshimi në vend të një komisioni tani janë bërë dy komisione.

**Ilirik Musliu:-** tha me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen të gjitha aktet nënligjore të cilat bien ndesh me këtë rregullore, pra që i bie këto çka janë të cekura në këtë rregullore, hapësirat publike, sheshet edhe bulevardet, nëse kemi kërkesa për këto, trajtohen me rregulloren për të cilën tash po votohet, ndërsa pjesa tjetër trajtohet me rregulloren e vitit 2014, të cilat janë shtesë e detajuar.

**Gëzim Sveçla:-** tha të sillni rregullore të re, por disa pjesë që trajtohen me rregulloren e vjetër po bien ndesh edhe logjik edhe juridik se nuk mundesh me përgatit një rregullore të re që e trajton një çështje, ndërsa disa çështje që hyjnë në atë fushë i trajton rregullorja e vjetër d.m.th. ne i kemi dy rregullore për një punë.

**Doruntinë Maloku:-** kërkoi nga Leutrimi që ta lexojë titullin e rregullores së vjetër.

**Leutri Retkoceri:-** Rregullore për vendosjen e ndërtimit dhe largimit të objekteve të përkohshme në pronën publike, nuk do të thotë se është e njëjta, është rregullore tjetër.

**Gëzim Sveçla:-** a mund ta bëni një rregullore tjetër që i trajton çështjet e rregullores se vjetër dhe asaj të re.

**Doruntinë Maloku:-** natyrisht, të gjitha rregulloret duhet ta bëjnë update-n e ri, absolutisht, këtë rregulloren e re në pajtim me këtë rregulloren e vjetër duhet ta bëjmë update. Ajo rregullore ka hy në fuqi në vitin 2019, sepse kjo rregullore ka qenë në vitin 2014, me ligjin e vjetër.

**Gëzim Sveçla:-** tha është shumë në rregull, nëse krijohet një rregullore e re është krejt në rregull, nuk kemi asgjë kundërshtim, mirëpo nëse në rregulloren e re i trajton çështjet dhe nëse kjo është në fuqi në të njëjtën kohë, ato çështje nuk shfuqizohen me rregulloren e re, kurse kjo është dualizëm.

**Doruntinë Maloku:** dha sqarime lidhur me këto çështje.

**Nora Kelmendi :-**kërkoi interpretim prej zyrës ligjore si KPF, a mund ta përdorin rregulloren e re çështjet e rregullores se vjetër.

**Diellon Gjonbalaj:-** tha se nuk ka informata për këtë pyetje.

**Gëzim Sveçla:-** tha se me këtë rregullore nuk jeni duke ua bërë jetën praktike qytetarëve, por vetëm jeni duke ia komplikuar.

**Doruntinë Maloku:-** dha sqarime shtesë.

**Gëzim Sveçla:-** tha neni 17 me hyrje në fuqi të e kësaj rregulloreje, shfuqizohen të gjitha rregulloret nënligjore, të cilat bien ndesh me këtë rregullore, cilave akteve në rregullore ju referohet kjo dispozitë.

**Doruntinë Maloku:-** tha Dispozita shfuqizuese e kësaj rregulloreje është neni 17, është çështje që e ka vendosur zyra ligjore.

**Gëzim Sveçla:-** tha si mund të vëmë diçka në asamble, para qytetarëve, para asamblistëve kur as zyra ligjore nuk ka një përgjigje për një dokument ligjor.

**Kryesuesi:-** tha sigurisht e kanë arsyetimin ata që e kanë punuar.

**Leutrim Retkoceri:-** e para e punës ne jemi duke biseduar për një rregullore të re për dhënien e pronës për me pak se 1 vit që po vjen si rregullore dhe shumë çështje po mbesin të pasqaruara në mungesë të kësaj rregulloreje dhe kjo është derivat i ligjit që parasheh dhe Kryetari i komunës mund t’i japë pronat më pak se 1 vit, kurse me rregulloren e vjetër ka një karakter të përafërt, por jo të njëjtë, i rregullon disa çështje tjera. Mirëpo unë mendoj në suaza të këtij diskutimi të pyetet zyra ligjore se a mund të harmonizohet neni 17 me një plotësim të vogël që definon dhe më tutje mos të ndeshen këto dy akte nënligjore të ndryshme. Çka duhet të përfshihet unë mendoj që paragrafi me hyrje në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen paragrafët, nenet dhe të gjitha aktet nënligjore që bien ndesh me këtë rregullore dhe sqaron në plotni sepse këtu ka të drejtë Gëzimi sepse mund të nënkuptohet se me vendosjen e kësaj rregulloreje shfuqizohet rregullorja tjetër që mund të lë hapësira për qytetarët në trajtim. Në fund tha mendoj se me këtë ndryshim pyeteni zyrën ligjore se a mund të sqarohet ky ndryshim nëse thuhet paragrafi, neni dhe të gjitha aktet nënligjore që bien ndesh me ligjin.

**Gëzim Sveçla:** - tha dua të krijohet një rregullore që e tregon mënyrën se qysh jepet prona komunale, për Komunën e Prishtinës, përveç Drejtorisë së Shërbimeve Publike, kjo është esenca. Kjo është pjesë e ndryshimeve të formimit e komisioneve, të cilat kanë qenë në përbërje tjetër kur e formon kryetari dhe marrin pjesë shumë drejtorë dhe tani pika 2.1 komisioni ku shumicën e ka Drejtoria e Shërbimeve Publike. Kjo determinon qartë se kjo rregullore dhe paqartësitë juridike që i ka janë pasojë e veprimeve dhe lëndimeve politike.

**Leutrim Retkoceri:-** dha sqarime.

**Bahri Gashi:** - shprehu shqetësimin lidhur me rregulloren i cili tha se ky është konflikt i brendshëm pasi ekzistojnë dy rregullore, në ç’rast kërkoi të përgatitet një rregullore në mënyrë që qytetarët ta kenë më të qartë se ku duhet të drejtohen, duke shtuar se me këto rregullore që i keni sjell sot ua keni vështirësuar punën qytetarëve.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim – rregullorja për përcaktimin e procedurave dhe formave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për më pak se një vit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e katërt**

**Propozim – rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës, 01-434/01-0094474/17, dt. 24.4.2017**

**Arbër Sadiki:** - ne jemi duke punuar në hartimin e rregullores së re dhe plotësim-ndryshimi ka të bëjë me heqjen e kësteve gjatë procesit të dhënies së lejeve ndërtimore dhe kjo është bë me të vetmin qëllim sepse ne kemi gjet një numër të madh të borxheve sepse leja ndërtimore është lëshuar vetëm me pagesën e këstit të parë dhe qytetari më nuk ka bërë asnjë pagesë.

**Osman Billaca:** - tha kjo është bë me kërkesën edhe të auditorit është mirë që është bë implementimi i rekomandimit që të bëhet pagesa e mandej të merret shërbimi sepse nga mospagesat e tilla na janë krijuar borxhet e tilla. E keqja është se te këto raste nuk ka pas masë penalizuese, por ka marrë dhe leje tjetër.

**Gëzim Sveçla:** - pyeti drejtorin se a ka qenë më mirë të bëhet një veprim i tillë apo të merren masa për inkasim të borxhit sepse ky vendim ka kosto ekonomike të madhe pasi ka mundur të kryhen shumë punë që kanë qenë të planifikuara, kështu që kish qenë më e rrugës t’i gjeni masat për inkasim të borxhit sepse



kjo nuk të garanton që ke me inkasu borxhe. Ju mund të ndaloni mos të futuni tani e tutje në borxhe, por nuk mund ta ktheni borxhin.

**Arbër Sadiki:** - tha se është caktuar një komisioni i cili do të merret me borxhe, të cilat raste i kemi identifikuar, por është problematike çështja e inkasimit sepse ka lloje të ndryshme të borxheve dhe kontrata po ashtu të ndryshme dhe për atë po zvarritet gjithçka. Për shkak të një numri jo të vogël po penalizohen edhe ata që bëjnë pagesa të rregullta.

**Gëzim Sveçla:** - kemi mundur të bëjmë si shtesë që kjo rregullore vlen për ato subjekte juridike që nuk kanë obligime ndaj komunës.

**Arbër Sadiki:** - paraqiti shqetësimin se subjektet juridike çdoherë e ndërrojnë formën, mund ta regjistrojnë biznesin në emër të dikujt tjetër për shkak të borxhit.

**Bahri Gashi:** - pyeti drejtorin a mendon që kjo rregullore të hyjë në fuqi më 4 janar, si dhe pyeti për urgjencën e kësaj rregulloreje meqë është futur për këtë mbledhje të jashtëzakonshme.

**Arbër Sadiki:** - tha se është superemergjente çështja e inkasimit të mbledhjes se mjeteve sepse vazhdimisht kemi probleme.

**Bahri Gashi:** - tha se pas janarit lëvizja e qytetarëve jashtë vendit ndoshta-do të jetë më e dukshme dhe sigurisht niveli i ndërtimit ka rënë, ka kriza dhe çmimet jo stabile, kurse pyeti a jeni ju të gatshëm t'ju kërkonte shuma të mëdha bizneseve për leje ndërtimi, a mos po e ngarkoni shumë industrinë e biznesit.

**Arbër Sadiki:** - tha se përqindja në raport me investimin do të jetë shumë e vogël.

**Bahri Gashi:** - pyeti se sa do të jetë shuma për një objekt me 2000 metra katror.

**Arbër Sadiki:** - tha, se do të jetë 20 euro metra katror.

**Leutrim Retkoceri:** - pyeti se në radhë të parë a i kemi qytetarët apo ndërtuesit duke shtuar se qytetari do të jetë në radhë të parë pasi paguan taksën.

**Bahri Gashi:** - kërkoi që të mendohet për taksa më të ulëta për bizneset, së paku me dy apo tri këste të bëhen pagesat dhe të krijohet një afat kohor për pagesa prej 6 -8 muaj.

**Leutrim Retkoceri:** - tha se rregulloren e kemi parë dhe e kemi trajtuar dhe dy çështje që duhen shtruar janë: me hyrjen në fuqi të rregullores, a obligohen borxhlinjtë - kompanitë që kanë borxhe me i marrë ato borxhe me këtë rregullore që është, apo mbetet në fuqi siç ka qenë, dhe pyetja e dytë: me rastin e marrjes së taksave në dy pjesë që e ka caktuar komuna, a e lehtëson qytetarin me ardh te fleta poseduese dhe pranimin teknik me realizu komuna. Ky është problemi mendoj sepse siç e ceku rastin e një objekti të ri ku 70 % e qytetarëve të atij objekti janë pa fletë poseduese dhe a e ndihmon komuna këtë rast.

**Arbër Sadiki:** - tha se një masë e madhe e ndërtesave që nuk kanë fletë poseduese është se nuk kanë leje të përdorimit, nuk kanë pranim teknik. Një numër jo i vogël nuk shkojnë deri në fazë të pranimit teknik, pikërisht pse nuk e përmbyllin me pagesën e taksave sepse nuk mundet me përmbyll procesin pa e paguar edhe taksën e fundit, kurse kjo ka kontribuar që shumë ndërtesa të mbesin pa leje ndërtimore dhe nuk mund të bëhet bartja e pronës tek qytetari. Për këtë arsye jemi munduar ta kemi rregulloren që të jemi më korrekt me taksat, me qytetarin, me ndërtimin, etj.

**Bahri Gashi:** - Pyeti se çka do të bëjë komuna me krejt ato objekte të banimit që nuk kanë leje.

**Arbër Sadiki:** - dha sqarime për pyetjen e parashtruar nga parafolësi.

**Nora Kelmendi:** - tha, ju thatë me herët që këtë rregullore e keni bërë për shkak të borxheve, ku e paskeni ju vendimin.

**Arbër Sadiki:** - tha po për me i mbledhur borxhet, për mos me lind borxhe te reja.

**Nora Kelmendi:** - A keni ndonjë mekanizem me anë të cilës nuk i jepni lejen e re një ndërtuesi pa e bërë pranimin teknik.

**Arbër Sadiki:** - dha sqarime në pyetjen e parashtruar nga parafolësja.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim – rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës, 01-434/01-0094474/17, dt. 24.4.2017 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e pestë**

**Propozim –vendimi për caktimin e shkallës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024**

Lidhur me këtë propozim-vendim dha sqarime **Valbona Makolli** – drejtore, duke shtuar se dallimi në mes të asaj që e kemi dërguar në kuvend është se shkruan aty neni 2 dhe 9 është neni 39/A, Ligji 08L/224, për ndryshim-plotësim për ndryshimin e Ligjit 06L/005 për Tatimin në Pronë, ku bëhet caktimi i shkallës tatimore për vitin 2024. Në bazë të analizave të Drejtorisë së Financave këtë që ia kanë paraqit kryetarit dhe në pajtim me kryetarin janë përcaktuar normat tatimore për këto kategori veç të cekura. Detajet kemi me u munduar me i dhënë nëse keni ndonjë koment, d.m.th janë rregulloret e publikuara në web faqen e ministrisë dhe tonën për çka jemi thirrur këtu dhe materiali mbi 50 faqe është publikuar nëse keni nevojë, prej vitit 2018 jam në gjendje t’ju dërgoj ndaras sepse materiali është shumë i gjërë, nëse e shihni të arsyeshme mundem edhe t’ju dërgoj në ato të cilat jemi thirrur, të Minsitrisë së Financave.

**Gëzim Sveçla:** - pyeti drejtoreshën a kanë bërë ndonjë llogaritje te kjo rezidenciale të objektit të cilin e keni lënë 0.15%, për arsye se keni thënë se qeveria, faktikisht ministria e ka lejuar një zbritje prej 30,000.00 euro.

**Valbona Makolli:** - dha sqarime për pyetjen e parashtruar nga parafolësi.

**Gëzim Sveçla:**- është bërë goxha bujë e madhe që ka qenë një mbivlerësim i pronave dhe është mbivlerësim i pronave në anën tjetër, dhe po thuani se 80% e objekteve në Vranjefc kanë vlerë nën 30,000.00 euro.

**Bahri Gashi:** - pyeti se kush e ka bërë këtë vlerësim të pronave.

**Valbona Makolli:**- tha Ministria e Financave, tatimi në pronë.

**Gëzim Sveçla:**- tha po i penalizoni, p.sh Bregut të Diellit, me ia bë shkallën tatimore qysh e kanë tjerat 0.10%, disa atje janë larguar prej bazës dhe është diskriminim i pjesës më të madhe të qytetit, për shkak se një kategori e caktuar e lagjeve periferike janë kryesisht varfanjake.

**Valbona Makolli:**- tha kjo është e vërtetë, unë e mora shembull një vlerësim, të njëjta i kanë edhe kategoria që i përfshin fshatrat, prej 26 zonave ministria këtë vit i ka bërë nga 44 zona.

**Gëzim Sveçla:**- tha se shumë pak ka banesa, po flasim për njësi banesore të cilat vlerësohen me 30,000.00 euro, se është bërë shumë problem vlerësimi i lartë e të tjera.

**Valbona Makolli:**- dha sqarime për çështjet që i ceku parafolësi.

**Gëzim Sveçla:** tha po më duket se nuk është mirë për shkak të një pjese të caktuar që asgjë nuk ish bërë të largohet krejt prej bazës tatimore, ai që e ka vlerën e shtëpisë nën 30,000.00 euro.

**Valbona Makolli:**- dha sqarime se ne përveç që paguajmë duhet të paguajmë edhe oborrin dhe tokën përfundi shtëpisë. Aty është problemi se ne kemi shumë problem teknikisht me vlerësuar dhe është e drejtë e juaj të pajtoheni apo jo.

**Gëzim Sveçla:** pyeti se tarifa sa e arrin tavanin.

**Valbona Makolli:**- Tavanin e kemi mbërri me 17,000,000.00 euro, por nuk e kemi llogaritur edhe ngarkesën se nuk e dimë a i paguan njerëzit apo jo atë nuk mundem me e fut. Për detaje me të hollësishme në Kuvend i kam edhe personat, që për pyetje kanë me qenë aty prezent për sqarime.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozim –vendimi për caktimin e shkallës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Kryesuesi:-** tha sa i përket pikave 6, 7, dhe 8 për shkak të vonesës për seancë të paraparë të Kuvendit i diskutojmë në kuvend.

**Seniha Bajraktari:-** tha jam kryesuese e komisionit për hartimin e Planit të veprimit për cilësinë e ajrit, kërkesë e Komisionit Evropian ka qenë. E kemi filluar nga viti 2021 këtë dokument, herën e fundit e kam raportuar para dy jave, kam thënë se në mbledhjen e nëntorit do të aprovohet në Kuvend, përndryshe të gjitha procedurat i ke.

**Gëzim Sveçla:-** pse nuk e keni sjell më herët.

**Seniha Bajraktari:-** tha se ka pasur procedura tjera, d.m.th është dashtë të dërgohet për lekturim, është dashtë të dërgohet te Ministria e Planifikimit Hapësinor. Dy herë e kemi dërguar, njëherë si dokument si draft, mandej si draft përfundimtar, unë kam raportuar se në nëntor kemi me pas dhe është kërkesa nga Komisioni Evropian.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:00.*

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**



**Kryesues i Komitetit  
Pëllumb Bajcinovci**